

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE**  
**KUFIZUAR**  
**“DRINER” Sh.p.k**

**Tirane me 29.07.2019**

Ne kete statut

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, me 29/07/2019, une themeluesi, kam krujuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emerin “DRINER” SH.P.K

(2) Themeluesi i shoqerise eshte:

- **Bajraktari Jetmir**, shtetas shqiptar, lindur më 01.09.1977 në Brisë, Tropojë dhe banues në Tiranë, me nr. personal H70901073E madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Prodhimi energjise elektrike pra burimet e rinovueshme. Ndertimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme. 'Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit. Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese per transmetimin e energjise elektrike.

Operator i sistemit te transmetimit te energjise elektrike dhe te dispecerimit 2 (axhustim ose rregullimi i prodhimit te energjise elektrike ne nivel kombetar. Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit, te mesem dhe te ulet, duke patur

parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit. Shoqeria mund te bashkepusoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri, firma, agjenci dhe ndermanje te tjera, te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktiviteti. Import makinerish industriale qe do te bejne te mundur kryerjen dhe realizimin e objektit te kompanise. Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe lose pjesemanjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri ne baze te legjislacionit shqiptar.

Punime ne Fushen e Ndertimit dhe Rikonstruksioneve. Nderitime civile dhe ekonomike, industriale, turistike. Nderitime rrugore, kanale vaditjeje, nderitime hidroteknike, rikonstruksione godinash civile. Ndertimin e rrjeteve inxhinierike. zbatim, mirembajtje periodike, riparim dhe rehabilitim ne fushen e automatizimit industrial ne makineri , mjete, pajisje, sisteme te ndryshme elektrike, elektronike, mekanike si : Sisteme, impiante, linja te trajtimit te mbetjeve; sistemime, impiante, linja komandimi per HEC- e, centrale, nenstacione TN, TM, TU; sistemime, impiante, linja ne mjete te renda transporti, paisje ulese - ngritese si ashensore, vinca mobil portual dhe civil, vinca elektrike portual dhe civil; sisteme, impiante, linja automatizimi ne industri; sisteme, impiante, linja, kapanone te lidhura me prodhimin;, sisteme, impiante, linja te ftohjes dhe te ngrohjes (kondicionimit). Mirembajtje, operim, menaxhim rruge, tynele, ura, mbikalime. Ndertim i tuneleve, urave, mbikalimeve. Punime ne Fushen e Ndertimit, Shkolla, Ndertesa Civile, Pallate, Ujesjellsa, etj, Rikostruksione ne Fushen e Ndertimit ne Ndertesa Civile, Pallate, Ujesjellsa, etj.

### **Neni 3:**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pa kufizuar.

### **Neni 4:**

#### **Selia**

- (1) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Lagjia "Kasaj", Rruga "Trojet", zona kadastrale 2011, Nr. Pasurie 351/2/8, Tropoje.
- (2) Adresa e faqes se internetit te shoqerise eshte (nese ka): nuk ka
- (3) Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon (nese ka): nuk ka

## **Kreu II**

### **Kapitali**

### **Neni 5:**

#### **Kapitali themeltar**

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 leke. Pjesemarrja e themelueseve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:
  1. Ortaku themelues **Jetmir Bajraktari**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100 leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajshme/te paluajshme apo te drejta)

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto contribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### **Neni 7:**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit ten je shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermejt:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk prashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lisrisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **Kreu III**

#### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8:**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organ ii vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organ ii vetem vendimmarres i shoqerise qe mirat cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e mepostme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze ten je autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne sin je perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 9:**

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permabje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikese 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavarsisht parregullsisë.

#### **Neni 10:**

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund e marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithsme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 11:**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoterueseve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
  - b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
  - c) Emerimin e shkarkimin i lukuidueseve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - ç) Percaktimin e shperblimeve;
  - d) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetoredhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - e) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - f) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;
- Cdo ndryshim statutiduhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12:**

#### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
  - a) Vleresimin e veprimtarise se tij;
  - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
  - c) Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
  - ç) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### **Neni 13:**

#### **Administrimi**

- (1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riparteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administrator ten je shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavleshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat):

dhe specimenet e nenskrimit:

#### **Neni 14:**

#### **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga sambleja e pergjithsme;
- b) Perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shpernadrjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) Krijojne nje system paralajmerimi ne Kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- ë) Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- Sipas bilacit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

#### **Neni 15:**

#### **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faj te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

1. a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;  
 b) Te ushtroje kompetenca qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne kete dispozita;  
 c) Te vleresoj pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;  
 ç) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;  
 d) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizimin dhe kujdesin e nevojshem.
  2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
  3. Nese administrator vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
  4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administrator eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersizim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:
    - a) U kthen ortakeve kontributet;
    - b) U paguan ortakeve interesa apo dividend;
    - c) U shperndan aktivet shoqerise;
    - ç) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
    - d) Jep kredi.
- Perverc padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **Kreu IV**

##### **Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16:**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17:**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## **Kreu V**

### **Prishja – riorganizimi i shoqerise**

#### **Neni 18:**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shoqeria ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise

ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

- d) Me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuidueseve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### **Neni 19:**

#### **Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.”

#### **Neni 20:**

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqitar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjetër specific ne republikën e Shqiperise.

Jetunis Bajraktari

